

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2009

LËNDA: EKONOMI - FILOZOFI

VARIANTI A

E premte, 10 korrik 2009

Ora 10.00

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pikët										
Kërkesa	11	12a	12b	13	14a	14b	14c	15	16a	16b
Pikët										
Kërkesa	16c	17	18a	18b	18c	19	20a	20b	20c	
Pikët										

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.Anëtar

2.Anëtar

1. Kufiri i mundësive të prodhimit të një vendi quhet: **1 pikë**
- A) niveli më i lartë i mundshëm i prodhimit të një vendi
 B) niveli më i ulët i prodhimit që arrin realisht një vend
 C) kombinimi i produkteve industriale me ato bujqësore sipas nevojave të konsumatorëve
 D) sasia e burimeve natyrore të një vendi.
2. Modeli i tregut të konkurrencës së plotë ka karakteristikë: **1 pikë**
- A) është çmimpërcaktues
 B) hyrja dhe dalja në treg është e vështirë
 C) produktet dhe shërbimet janë të njëjlojta
 D) shitësit dhe blerësit nuk e zotërojnë informacionin e plotë.
3. Standardi i jetesës llogaritet si: **1 pikë**
- A) raport i numrit të popullsisë me produktin e përgjithshëm kombëtar real
 B) raport i produktit të përgjithshëm kombëtar real me numrin e popullsisë
 C) raport i produktit real me sasinë e faktorëve të përdorur
 D) raport i faktorëve të përdorur me produktin real.
4. Kërkesa për një mall në lidhje me çmimin e tij është më elastike kur: **1 pikë**
- A) sa më shumë zëvendësues të afërt të ketë malli
 B) sa më themelore të jetë nevoja që plotëson malli
 C) sa më e vogël të jetë pjesa e të ardhurave e shpenzuar për mallin
 D) të tria alternativat e mësipërme.
5. Taksat progresive janë ato: **1 pikë**
- A) që paguhen në përqindje më të mëdha për të ardhura më të mëdha
 B) kur të gjithë paguajnë të njejtën përqindje të të ardhurave
 C) që paguhen në përqindje më të vogla për të ardhura më të mëdha
 D) ku bëhet kalimi i barrës së taksës në formën e çmimeve më të larta.
6. Hegeli flet për një arsye: **1 pikë**
- A) që mbrohet bashkë me lirinë
 B) që shpaloset në histori
 C) gjykohet nga ligji moral
 D) që lufton egoizmat njerëzorë.
7. Çfarë do të thotë Frojdi kur shprehet se **UNI** nuk është zot në shtëpinë e vet? **1 pikë**
- A) Njeriu nuk duhet të ndrydhet nga shoqëria.
 B) Njeriu ka zbuluar aftësitë e tij për të bërë analizën e vetvetes.
 C) Njeriu ndryshon marrëdhënien e të kaluarës me të tashmen.
 D) Individit nuk e njeh kurrë veten e vet.
8. Teoria intelektualiste shprehet se besimi përcaktohet nga: **1 pikë**
- A) qartësia e brendshme e idesë
 B) vullneti
 C) arbitri i lirë
 D) ideali moral.

9. Problemi moral shtrohet se: 1 pikë
- A) as natyra njerëzore dhe as shoqëria nuk janë të përkryera
 B) natyra njerëzore është e përkryer, por shoqëria jo
 C) natyra njerëzore nuk është e përkryer, ndërsa shoqëria po
 D) edhe natyra njerëzore, edhe shoqëria janë të përkryera.
10. Mund të quhet ndryshe “*e drejtë racionale, morale, ideale ...*” 1 pikë
- A) e drejta natyrore
 B) e drejta pozitive
 C) e drejta ndërkombëtare
 D) e drejta kushtetuese.
11. Gjeni tri prej shtyllave të sipërmarrjes së lirë. 3 pikë
- a) _____
 b) _____
 c) _____
12. Jepni përkufizimet e koncepteve ekonomike të mëposhtme.
- a) Elasticiteti i ofertës lidhur me çmimin _____ 1 pikë

- b) Funkzioni i ofertës së një malli _____ 2 pikë

13. Cilat janë të metat e korporatës? 3 pikë
- a) _____
 b) _____
 c) _____
14. Duke analizuar situatat e mëposhtme përcaktoni se cilën formë të papunësisë ato përfaqësojnë.
- a) Një student i sapodiplomuar si mjek është i papunë sepse nuk dëshiron të shkojë 1 pikë
 të punojë si mjek në një fshat të largët të Tiranës _____
- b) Për shkak të rënies ekonomike që po përjeton një ekonomi një numër punëtorësh 1 pikë
 janë pushuar nga puna _____
- c) Pas vitit '90 për shkak të mbylljes së shumë fabrikave të industrisë mekanike, 1 pikë
 shumë inxhinierë mekanikë mbetën pa punë _____

15. Burimet e zakonshme të financimeve afatgjata janë:

3 pikë

a) _____

b) _____

c) _____

16. Për Dekartin çdo filozofi është si një pemë:

a) rrënja e së cilës është: _____ 1 pikë

b) trunгу i së cilës është: _____ 1 pikë

c) dhe degët e këtij trunгу janë: _____ 1 pikë

17. Te njeriu kohësia përbëhet nga tre aspekte: e ardhmja, e tashmja dhe e kaluara. Në cilët akte të shpirtit bazohen këto aspekte?

3 pikë

a) _____

b) _____

c) _____

18. Si e trajtojnë nocionin “e tjetrit”:

a) psikologjia: _____ 1 pikë

b) sociologjia: _____ 1 pikë

c) psikoanaliza: _____ 1 pikë

19. Gjeneri tri arsye pse “gjuha” e kafshëve nuk është gjuhë në kuptimin njerëzor.

3 pikë

a) _____

b) _____

c) _____

20. Plotësoni:

a) Aristoteli e shikonte filozofinë si: _____ 1 pikë

b) Ç’do të thotë të filozofosh për Platonin? _____ 1 pikë

c) Cili është një nga momentet më të rëndësishme që të jesh i lumtur sipas skeptikëve?

1 pikë
